

VENDIM
Nr.11, datë 13.1.1997

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË PORTIT TË DURRËSIT

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim projektin e rehabilitimit të portit të Durrësit.
 2. Projekti do të financohet nga Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA) me një bashkëfinancim të mundshëm nga Qeveria shqiptare dhe fondi i OPEC-ut. Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj do të detajojë paketën e financimit të projektit.
 3. Autorizohet Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj të bëjnë kërkesë pranë donatorëve, sipas paketës së financimit të projektit.
 4. Ngarkohen Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Ministria e Financave dhe Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe i Koordinimit të Ndhmës së Huaj të negociojnë me donatorët për këtë projekt.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi